

PERMBLEDHJE E RAPORTIT TE VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN
“INDUSTRITE PRODHUESE TE MAKINERIVE
DHE PAISJEVE” ID.10.1” ”PRODHIMI I
MAKINERIVE DHE PAISJEVE”



	<p>DOKO Sh.P.K</p>	<p>Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k</p>
---	---------------------------	---

Hyrje

“DOKO” SH.P.K. është kompania lider në industrinë e prodhimit të strukturave metalike në Shqipëri. Ajo është e përfshirë në aktivitete të projektimit, prodhimit të strukturave metalike, montimit dhe instalimit të konstruksioneve metalike, linjave të prodhimit dhe pajisjeve, objekteve infrastrukturore dhe ndërtesave industriale. Mbështetur në Standartin e Cilësisë ISO9001:2015, ISO14001:2004, OHSAS18001:2007, EN1090:2012, PASS 99:2012. DOKO sh.p.k ka zhvilluar dokumentuar dhe implementuar një sistem të Manaxhimit të Cilësisë. I gjithë stafi i “DOKO” SH.P.K. nga drejtori teknik, drejtori financiar, manaxheri i cilësisë dhe punonjësit e tjerë verifikojnë dhe ndjekin proceset që kanë ndikim mbi cilësinë e produktit. Nëpërmjet mjeteve të menaxhimit ajo ka aftësinë në mënyrë aktive se formimit në të ardhmen, duke identifikuar dhe implementuar tendencat në mënyrë fleksibile për tu përgjigjur kërkesave të tregut dhe të klientëve tanë. Qëndrueshmëria është një pjesë e madhe e zakonit tonë të punës dhe procedurave. Aktualisht "DOKO"SH.P.K.prodhon rreth 100 ton konstruksione metalike në muaj. Duke bërë një përdorim më të mirë të ambjenteve të punës, pajisjet e reja në të cilat kompania ka investuar dhe rritjen e fuqisë punëtore, planifikon të arrihet në 250 ton në muaj. Në realizimin e prodhimeve cilësore, një ekip shumë i mirë prej 25 punonjësish ndërkohë që shumica e tyre janë me eksperiencë të gjatë pune. Në politiken e saj të biznesit, “DOKO”SH.P.K.ka rritjen e eksperiencës nëpërmjet shtimit të forcave të reja. Për këtë arsye kompania i kushton një vemendje të veçantë rekrutimit të punonjësve të rinj që kanë pasion dhe dëshirë për të punuar me konstruksione metalike.

Gjithashtu, është kujdestare kulturore dhe mjedisore për komunitetet në të cilat jetojnë dhe punojnë. Ajo synonë të arrijnë nivelet komerciale dhe reputacionin më të lartë, e realizuar këtë duke ofruar produktet më të sigurt, me cilësi më të lartë dhe kosto më të ulët.

Kompania “DOKO”SH.P.K.ofron shërbime në të gjitha llojet e projektimit, prodhimit, instalimit të ndërtimeve të ndryshme metalike që realizohen nga një ekip shumë profesional dhe me përvojë më shumë se 26 vjeçare në këtë fushë. Produktet dhe shërbimet përfshijnë: Projektimin, prodhimin dhe instalimin e magazinave industriale, dyqaneve me konstruksione metalike, etj; Prodhimin dhe instalimin e strukturave civile. Prodhimin dhe instalimin e pajisjeve për transportin industrial dhe civil (llojet e ndryshme të vinçave, teleferikeve, ashensoreve civile dhe industriale); Prodhimin e shtyllave të tensionit të lartë, antenave të telekomunikacionit; Tuba dhe sisteme të shpërndarjes së gazit dhe karburantit Tanke për stacionet e naftës; Montimin e urave të prodhimit metalike; Instalimin e strukturave modulare; Makineri të ndryshme industriale, makineri zmusimi dhe kalander. “DOKO” Shpk ofron gjithashtu shërbime të lidhura me industrinë mekanike. Kompania bën çdo përpjekje për të qënë gjithmonë profesionale në ofrimin e shërbimeve të tilla si:

	<p>DOKO Sh.P.K</p>	<p>Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k</p>
---	---------------------------	---

arsye kompania i kushton një vemendje të veçantë rekrutimit të punonjësve të rinj që kanë pasion dhe dëshirë për të punuar me konstruksione metalike.

Struktura është ndarë në disa sektorë sipas profilit të punës: Sektori i prodhimeve të konstruksioneve metalike që përfshin prodhimin e tubacioneve metalike të presioneve të larta, prodhimin e shtyllave të tensionit të lartë, prodhimin e antenave për telekomunikacion, prodhimin e konstruksioneve metalike për kapanone industriale etj.; Sektori i prodhimit të tjegullave; Sektori i prodhimit të bojrave; Magazina. Drejtimi i kompanisë përbëhet nga një staf i kualifikuar të cilët janë të vendosur pranë zyrave përkatëse në Elbasan dhe Tiranë.

Gjithashtu, është kujdestare kulturore dhe mjedisore për komunitetet në të cilat jetojnë dhe punojnë. Ajo synonë të arrijnë nivelet komerciale dhe reputacionin më të lartë, e realizuar këtë duke ofruar produktet më të sigurta, me cilësi më të larte dhe kosto më të ulët.

Kompania “DOKO”SH.P.K.ofron shërbime në të gjitha llojet e projektimit, prodhimit, instalimit të ndërtimeve të ndryshme metalike që realizohen nga një ekip shumë profesional dhe me përvojë më shumë se 26 vjeçare në këtë fushë. DOKO shpk ofron gjithashtu shërbime të lidhura me industrine mekanike. Kompania bën çdo përpjekje për të qënë gjithmonë profesionale në ofrimin e shërbimeve të tilla si:

- Konsultime ne fushen mekanike me klientet tane potenciale
- Diagnostifikimin dhe identifikimin e problemeve apo defekteve në konstruksionet dhe strukturat metalike.
- Zgjidhja e problemeve me pajisjet mekanike.
- Riparimin e pajisjeve dhe konstruksioneve me probleme.

DOKO ofron shërbimin e garancisë për produktet.

“DOKO”SH.P.K.është zgjeruar dhe diversifikuar në dekadën e fundit, por vijon të ruajë filozofinë thelbësore të cilësisë së produktit, konsulencën për klientet potenciale, përgjegjësinë ndaj komunitetit dhe planifikimit e kujdesshëm për të ardhmen. Ajo fokusohet në bashkepunimin efektiv dhe zgjidhjet me përfitim dypalesh. DOKO shpk është themeluar në vitin 1995 dhe operon në Shqipëri, e specializuar në projektimin, prodhimin, montimin e konstruksioneve metalike destinuar për fushën industriale dhe me aplikueshmeri hidraulike. Historia e Kompanisë “DOKO”SH.P.K. ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1995. Ambjentet e punës dhe zyrat janë të vendosura në Elbasan, Shqipëri. Me kalimin e kohës dhe me konsolidimin ekonomik, kompania ka bërë të mundur realizimin e punimeve në një mjedis tërësisht të dedikuar ndaj konstruksioneve metalike, në një sipërfaqe prej 11400 m², nga të cilat mbuluar 6400 m². Ambjentet janë të pajisura me rreth 20 makineri të ndryshme, të cilat mundësojnë të dizenjohet, prodhohet dhe të montohen komplekse të ndryshme civile dhe industriale. Kjo rritje e vazhdueshme ka ngitur “DOKO”SH.P.K.në nivelin e një prej prodhuësve më të mëdhenj të strukturave metalike

	<p>DOKO Sh.P.K</p>	<p>Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k</p>
---	---------------------------	---

në vend. Sa më sipër u shfaq duke marrë pjesë në një gamë të gjere projektesh komplekse për standardet lokale.

Ky material synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, njekohesisht çdo ndikim social ekonomik , permiresimin e infrastructures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale. Nga ana e subjektit eshte parashikuar dhe planifikimi i masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit si dhe shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit. Nepermjet ketij projekti do te jepet gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit, analiza e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimine ndikimeve negative, nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit, Propozime te masave zbutese te ndikimit ne project etj.

Qellimi i ketij aktiviteti eshte “Prodhimi i makinerive dhe paisjeve”ne mbeshtetje te plote me kushtet mjedisore me standarte bashkohore, per permbushjen e kerkesave te investitorit per projektin qe do te realizohet. Proçeset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

Vendndodhja: Objekti ndodhet ne pjesen juglindore te ish Kombinatit metalurgjik dhe ze nje sipërfaqe totale prej 11400 m², nga të cilat mbuluar 6400 m².

Zona Kadastrale 2124, Numuri pasurise 75/27, 75/28, 75/30, Indeksi i Hartes EL:I-6; J-6; Kufizimet : Veri, Lindje, Jug dhe perendim jane me numurin e pasurise 916/4.

Lendet e para

Lendet e para ate perdorura kryesisht perfasohen nga tipe dhe lloje te ndyshme te çeliqueve qe mund te jene ne forme profilesh si: L, UPN, HEA, HEB, IPE, RHS, CHS, SHS, llamarinave te formave dhe dimensioneve te ndryshme si dhe material inoksidabel. Te gjitha keto jane sipas standarteve perkatese. Lende te para jane te depozituara dhe te sistemuara sipas llojeve ne magazine dhe ngarkimi e shkarkimi i tyre behet nepermjet nje vinci me kapacitet deri ne 5 ton

Proçesi teknologjik

Me poshte ne menyre skematike po paraqesim e gjithë fazat e proçesit teknologjik si dhe strukturen perkatese te subjektit per ushtrimin e ketij aktiviteti

	DOKO Sh.P.K	Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k
---	--------------------	--

Proçesi i prerjes dhe perpunimit te llamarinave: ne kete proçes perfshihen dy operacione ajo e tranxhimit te tyre ne trajte shiritash apo shkurtimi arritja e konfiguracionit. kjo arrihet me ane te paisjes

Proçesi i kalandrimite paisjeverrealizohet nepermjet paisjes kalandruese e cila ben kalandrimin e llamarinave ne te ftohte (realizohet nepermjet rulave te kalandres)

Kalandrimi i brezave –llamarinave kalon ne pergatitjen e shabllonave sipas diametrave te brezave dhe tolerancave te percaktuara sipas standartit. Nga ana e subjektit realizohen dhe kalandrime te tjera.

Proçesi perpunimit te profileve metalike.

Profilet metalike kane forma dhe dimensione te ndryshme dhe nga ky kend veshtrim realizohet dhe menyre e prerjes dhe perpunimit te tyre. Keto profile mund te jene L, UPN, HEA, HEB, IPE, RHS, CHS, SHSetj. Pasi percaktohen dimensioned e duhura realizohen prerjet e profileve me ane te sharrave eelektrike me hark elektrik, lloje perje keto qe zgjidhen nga specialistet sipas dimensionit qe do te perdoret dhe aftesive perpunuese te paisjeve.

Ne procesin e realizuar me sharra elektrike, merrte profile dhe vendoset ne bango dhe metej fillon prerja e tij.Ky operacion realizohet vetem vertikalisht dhe gjate proçesit te prerjes perdoret uje si agjent ftohes dhe lubrifikues.

Ne rastin kur prerjet kerkohen te jene kendore, perdoret nje pasije speciale e cila realizon kete proçes me anen e nje disku special te cilit i jepet kendi i duhur dhe me tej vihet ne levizje per ralizimin e prerjes se kerkuar;

Proçeset e ngjitjeve dhe saldimeve special

Ne keto proçese jane te kombinuara te gjithë llojet e saldimeve si ato klasike qe perfshijne saldimit me hark elektrik apo oksigjen ashtu dhe ato bashkekohore si saldimi me argon e pikatriçe.

- Saldimi sipas proçesit te saldimit MAG
- Saldimisipas proçesit te slaldimit SAW

Per te gjitha keto behet pastrimet nga sperkatjet e saldimit, kontrolli i deformacioneve per sejcilen nyje apo segment saldimi pas saldimit dhe pergatitja e raportit cilesor (Kontrolli i saldimeve me metodat pa shkaterim ku eliminohen defektet siperfaqore te linjat e saldimit apo siperfaqeve te llamarinave, gjithmone keto siaps standartit perkates, Kontrolli me metoden pa shkaterim X-Ray, Kontrollet me metoden pa shkaterim Ultrasonic(UT).

	DOKO Sh.P.K	Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k
---	--------------------	--

të parë do të konsiderohen elet barabrinjëse dhe llamarina, të cilat klasifikohen si çelique strukturorë.

Përpunimi i tyre në të ftohtë kërkon paisje / makineri speciale të cilat nëpërmjet fuqisë hidraulike, elektrike dhe mekanike arrijnë të ndryshojnë formën e tyre duke e përshtatur atë me produktin e kërkuar. Këto paisje / makineri prodhohen nga kompani më eksperience shume vjeçare në kete fushë dhe ofrojnë rendiment e cilësi në nivel të kënaqshëm.

Linja e prodhimit të shtyllave përbehet nga disa makineri me kontroll numerik si: makine CNC per prerje, shpim dhe markim të elementeve të shtyllës; makine CNC per shpimin e pllakave metalike; makine hidraulike per markim; makine hidraulike per prerje fallcosh; tranxhe hidraulike per prerjen e pllakave; pres hidraulike për kthimin e pllakave dhe eleve; etj.

Proçesi teknologjik kalon në disa etapa, të cilat janë si më poshtë:

- 1- **Inxhinieringu:** Ky është hapi i parë i proçesit. Këtu realizohet: projekti i shtyllës; vizatimet e detajuara per prodhimim; përgatitja e listave të materialeve; optimizimi i prerjeve të elementeve; programimi i elementëve ne gjuhen CNC; monitorimi i prodhimit të elementeve, si dhe kontrolli cilesor gjatë prodhimit.

- 2- **Lenda e Parë:** Përbënet kryesisht nga ele barabrinjëse, llamarina, bulona dhe materiale ndihmëse. Materiali është çelik strukturor me kualitet S 235 - S355 (sipas ISO). Lënda e parë magazinohet në ambiente të mbyllura për të shmangur korredimin si dhe sistemohet sipas tipologjis / materialit. Kontrolli cilësor, sasior i saj realizohet sipas furnizimeve të kryera në periudha të ndryshme. Gama e tyre është si më poshtë:
 - a) Ele barabrinjese: L 35x35x4 ÷ L 200 x 200 x 20
 - b) Bulona: M12 x 30 ÷ M24 x 90
 - c) Llamarina: δ2 ÷ δ40

- 3- **Perpunimi Mekanik:** Prodhimi i elementeve të shtyllës realizohet në përputhje me skadat teknike. Proçeset e punës që janë pjesë e perpunimit mekanik në të ftohtë janë si më poshtë:
 - a) Prerje në sharrë ose tranxhë profile L
 - b) Prerje ne tranxhe
 - c) Shpim me punsona ose punto metali
 - d) Markim me makinë hidraulike
 - e) Kthim në kende të ndryshme me presë
 - f) Axhustim dhe prerje kurrizi me makine oksigjeni

	<p>DOKO Sh.P.K</p>	<p>Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k</p>
---	---------------------------	---

g) Prerje fallcosh me makine hidraulike ose troko.

Të gjitha këto proçese realizohen me makineri CNC automatike dhe hidraulike te prodhuara posaçërisht për këtë industri. Me poshte paraqiten disa fotografi të makinerive që marrin pjesë në prodhimin e shtyllave të tensionit të lartë.

4- Kontrolli dhe Testimi: Në këtë etape realizohet kontrolli sasior, cilësor dhe testimi i kampioneve të marra gjatë prodhimit. Kontrolli sasior dhe cilësor realizohet nga një inxhinier i kualifikuar dhe në përputhje me standartin e menaxhimit të cilësisë. Testimi i kampioneve është gjithashtu një proçes mekanik që i nënshtrohet rregullave dhe standardeve përkatëse.

5- Paketimi: Eshtë hapi i fundit i proçesit teknologjik. Këtu realizohet paketimi i elementeve përbërës të shtyllës bazuar mbi proçedura jo standarde, por duke respektuar praktikat e punës. Ai realizohet nga punonjës të kualifikuar dhe kontrolli final bëhet nga një inxhinier QA.

✚ Paisjet / Makinerite dhe elemente ndihmes qe marrin pjese ne proçesin teknologjik.

Në vijim do të shpjegohen shkurtimisht roli i cdo paisje / makinerie dhe elementi ndihmës në proçesin teknologjik të linjës së prodhimit të shtyllave të tensionit të lartë.

1- CNC per shpim, markim dhe prerje Elesh, Modeli TAPM2020A: Makina shërben për përgatitjen e elementeve përberes të shtyllës sipas projektit të shtyllës. Makina është automatike me kontroll numerik (CNC) dhe realizon proçeset si: prerje të eleve sipas gjatësisë, stampimi i kodit identifikues të elementit dhe shpimin e vrimave. Të gjitha këto proçese kryehet sipas projektit të prodhimit të elementit.

Figura 3: Përgatitja e elementeve nga TAPM2020A





DOKO Sh.P.K

Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k

- 2- Makine Hidraulike per prerje fallcosh, Modeli TQJ140:** Makina shërben për prerjen e fallcove të elementëve 'L' të shtyllës. Makina është hidraulike dhe nëpërmjet forcës që ushtrohet në dy thikat prerëse realizohet prerja e copës në përputhje me projektin e prodhimit.

Figura 4: Prerja e fallcove nga TQJ140



- 3- Makine Hidraulike per markim, Modeli TDZ100:** Makina shërben për stampimin e kodit të elementit në ele dhe pllaka. Makina është hidraulike dhe nëpërmjet forcës që ushtrohet në stampen me kodin përkatës mbi elementin e shtyllës realizohet stampimi i kodit sipas projektit të prodhimit.


Figura 5: Stampimi i kodit nga TDZ 100



- 4- Tranxhe Hidraulike CNC (llamarine), Modeli RAS2530:** Tranxha hidraulike shërben për prerjen e llamarinave me spesor $t = 1 \div 30$ mm sipas përmasave të kërkuara nga projekti. Prerja realizohet nëpërmjet thikave sipas parimit të gërshërës. Makina është hidraulike dhe me kontroll numerik. Në tranxhe realizohet vetëm prerja e pllakave të shtyllës sipas gjeometrisë së kërkuar.

	DOKO Sh.P.K	Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k
---	--------------------	--

Firgura 6: Prerja e pllakave nga RAS2530



- 5- **Prese Hidraulike, Modeli Y32-250T:** Presa hidraulike sherben për kthimin e eleve dhe pllakave të cilat janë të pozicionuara në nyjet ky ka ndryshim të këndit të pjerresisë së shtyllës. Presa është paisje e përshtatur për kthimin e tyre nëpërmjet forces hidraulike qe ushtrohet në matricat shabllon të përgatitura sipas rastevet specifike.
- 6- **Vinç Ure 5T / 16.795 m, Modeli CXTS:** Vinçi ure do të instalohet në kapanonin e ri që do të ndërtohet dhe do të shërbejë për lëvizjen e lëndës së parë dhe produktit të gatshëm mbrenda repartit të prodhimit. Ai ka kapacitet 5 ton dhe lartësi efektive 6.8 m nga dyshemeja.
- 7- **Kapanon Industrial:** Instalimi i linjës teknologjike për prodhimin e shtyllave të tensionit të lartë kërkon shtimin e hapsirës e hapsirës magazinuese të lëndës së parë, produktit të gatshëm si dhe instalimit të makinerive që janë pjesë e këtij procesi. Kapanoni ka sipërfaqe rreth 1700 m² dhe lartesi efektive rreth 8 m. Ai është i ndërtuar me konstruksion metalik.
- 8- **Software per projektimin e shtyllave te tensionit te larte TECLA STRUCTURE:** Ky softuer është pjesë e automatizimit të linjës së prodhimit të shtyllave. Softueri do të përdoret për modelimin e strukturave metalike, testimin dhe përgatitjen e skedave teknike për prodhim. Ai do të lidhet në rrjetin e makinerive për të realizuar dhenien e programeve në mënyrë automatike. Programi rrit besueshmerine, cilësinë dhe rendimentin e prodhimit.

Firgura 7: Foto Ilustruese




DOKO Sh.P.K

Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k



**Makine hidraulike stampimi
fallcosh*

**Makine hidraulike per prerje*




** Makine CNC per shpim, markim dhe prerje Elesh*



DOKO Sh.P.K


Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k



**Vinç Ure 5T*



** Presa Hidraulike*



**Tranxhe hidraulike llamarine*

	DOKO Sh.P.K	Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k
---	--------------------	--

Operacione te tjera ndihmese

Ne kete aktivitet perfshihen te gjithë operacionet mekanike ndihmese qe u kryhen konstruksioneve dhe qe kane te bejne me procese tornimi, te elementeve ndihmese pergatija e dadove, bulonave speciale, dhe me anen e trapanave qofshin keto trapanave bange apo dore realizohen bira te ndryshme qe do realizojne kapjen e elementeve me njeri tjetrin.

Po keshtu realizohen dhe rrahjet apo presimet e ndryshme speciale qe punojne me ajer te komprimuar te cilet jane montuar ne kete linje. Ne objekt jane vendosur dhe gur zmerile dhe mjete e nevojshme per kryerjen e punimeve te axhustimit apo operacioneve te tjera.

Pergatitja e zmusove te saldimit.

Pas proceseve te ndryshme pergatitja dhe kontrolli e zmusove te saldimit ze vend te veçante. Kjo behet me kalibrin perkates.

Pastrimi me makinerite e reres eshte aktivitet ne ndihme te proceseve te tjera.

Siperfaqja pastrohet deri ne 15-25 mikron. Krahas saj behet dhe kontrolli perkates(brenda normave te percaktuara ne standart) dhe raporti perkates.

Per llamarinat:

Behet marketimi i llamarinave qe vjen nga prodhuesi sipas standartit njekohesisht behet dhe raporti i gjurmueshmerise se materialeve.

Lidhur me pergatitjen e flanaxhave ne trapan radial procesi kalon nga matja e permasave paraprake te tipeve te ndryshme, DJ, DB, realizohet shpimi i tyre dhe kontrolli i permasavesi dhe pergatija e zmusove per saldimit te flanaxhave sipas menyres se saldimit.

Pas pergatitjes se te gjithë materialeve do te realizohet montimi dhe saldimit i brezave dhe elementeve te tjere plotesues(saldimit i tyre me "Spot Weld"), montimi brezave me flanaxhat perkatese, montimi i elementeve te tjere si dhe kontrolli perkates i tyre lidhur me deformacionin qe mund te krijohet gjate montimit, riparimi dhe pergatitja per saldimit si dhe pastrimi nga sperkatjet e saldimit.

Proçesi i lyerjes (Realizimi i lyerjes behet per sasi te vogla).

Fillimisht realizohet proçesi i pastrimit te siperfaqeve me rere abrasive 05-1,2 mm ne menyre manuale dhe sipas standartit.

Behet pastrimi me ajer i siperfaqes si dhe kontrolli i parametrave te punes, se temperatures, lageshtise relative si dhe behet pergatitja e bojes nga dy komponente se bashku.

Lyerja realizohet ne disa faza.

Fillimisht realizohet lyerja me boje antikorodive si brenda dhe jasht (kjo realizohet sipas kerkesave teknike dhe sipas standartit). Trashesi e krijuar arrin deri ne 35 mikron.

Me tej behet lyerja e dyte me boje antikorodive ku trashesia e krijuar arrin ne 60-70mikron.

Lyerja e shtreses se pare nga jashte me boje dy komponente deri ne trashesine 70-80mikron

Lyerja e shtrese se dyte nga jashte me boje dy komponente deri ne trashesine 70-8- mikron Nga njera shtrese ne tjetren, koha e lyerjes duhet te jete jo me pak se 5 ore.

Pas perfundimit te ketyre proceseve elementet dalin nga dhoma e lyerjes per te realizuar montimin sipas projektit.



DOKO Sh.P.K

Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k

Infrastruktura

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik

Energjia qe do te perdoret do te jete energji elektrike e cila sigurohet nga rrjeti energjitik i zones nepermjet kontrates se lidhur me OSHEE.

Furnizimin me uje

Furnizimi me uje behet nga rrjeti i ujesjellesit te zones dhe nga pusi vetjak per te cilen kemi marre lejen perkatese nga AUB Elbasan. Nga ana jone eshte lidhur kontrata perkatese.

Rrjeti i Kanalizimeve. Shkarkimet e ujerave sanitare dhe reshjeve behen ne ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Identifikimi ndikimeve

Ajri

Nga aktiviteti ne mjedisin e jashtem nuk do te kete emetime te gazrave, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth.

Shkarkimet e ujrave

Nga aktiviteti nuk do te kete shkarkime te ujrave teknologjike dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth.

Zhurmat

Nga aktiviteti ne mjedisin e brendshem krijohen zhurma nga paisjet dhe makinerite qe punojne, por ndikimi i tyre ne mjedisin e jashtem eshte i paperfillshem.

Mbetjet.

Te gjitha mbetjet qe dalin nga ky aktivitet jane te riciklueshme. Mbetjet metalike u jepen subjekteve te licensuara, ndersa mbetjet urbane evadohen nga ndermarja perkatese e bashkise ne incineratorin e bashksie qe ndodhet ne zonen industriale.

Ndotja e tokes

Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem;

Sistemi i transportimit dhe ngarkim-shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Sistemi i terminalit te shkarkimit eshte i shtruar me beton dhe si rrjedhoje nuk do te kemi ndotjke te tokes, ne raste te derdhjes se lendes ne mjedis. Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo çdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne toke.

Automjetet dhe makinerite jane te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar papasterti te lendeve qe transportojne.

	DOKO Sh.P.K	Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k
---	--------------------	--

Përmbledhje e ndikimeve të mundshme negative në objektin ku realizohet aktiviteti

• Në Tokë

	<i>Ndikimi i mundshëm</i>	<i>Sqarim</i>
1	Shkarkimi i vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punës (avari teknike)	Bëhet fjalë për ndonjë rast të rrallë të rrjedhjes gjatë difekteve dhe çarjeve të tubave të instalimit dhe mjeteve të transportit

• Në Ajër

	<i>Ndikimi i mundshëm</i>	<i>Sqarim</i>
1	Shkarkimi i pluhurave	Mund të ketë vetëm në mjediste të brendshme gjatë aktivitetit, por nuk ka emetime jashtë Sasia e gazrave mund të ketë në mjediset e brendshme në procesin e saldimeve
2	Emetimi i zhurmave	Vlerat standarte të emetimit të zhurmave janë brenda standarteve. Në mjediset e punës zhurmat ndjehen me shumë ndërsa në mjediset e jashtme janë të papërfillshme sipas teknologjisë t. kontroll teknik të instalimit.
3	Ngritja e grimca të pluhurit	Gjatë transportimit të lëndës së parë dhe gjatë pastrimit të makinerive/pajisjeve.

Vlerësimi i rëndësisë të ndikimeve në mjedis të aktiviteti

<i>Receptori i ndikimit</i>	<i>Shtrirje fizike madhësia</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Kthyeshmëria</i>	<i>Rëndësia si shumatore e shtrirjes, kohëzgjatja dhe kthyeshmëria</i>	<i>Nevojat për masat zbutëse</i>
TOKA					
Shfrytëzimi i ambientit/territorit	Lokale	Përhershëm (objekt ekzistues)	Po	I pa rëndësishëm	mirëmbajtja e godinës, linjave dhe territorit përreth
Ndikim në	Lokale	Gjatë gjithë	Po	I pa	Vendosja e

	DOKO Sh.P.K	Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k
---	--------------------	--

gjenerimin e mbetjeve të ngurta urbane		periudhës së prodhimit		rëndësishëm	kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve sipas llojit
BIODIVERSITETI					
Shqetësim i faunës së zonës	Lokale	Përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Është zonë e varfer me gjallesa
Ujrat					
Shkarkimi i ujrave teknologjik	Lokale	I Përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Nuk ka shkarkime të ujrave teknologjike. Nedersa Shkarkimi i ujrave sanitare do të bëhet në rrjetin e kanalizime të zonës
AJER					
Shkarkimi i gazrave nga motorrat që punojnë me lëndë djegëse fosile	Lokale	I përkoshëm	Po	I pa rëndësishëm	Kolaudimi dhe kontrolli i çlirimit të gazrave në skapamentot e makinerive
Emetimi i grimcave të pluhurit	Lokale	Vetem gjate depozitimit te lendes se pare	Po	I pa rëndësishëm	Lëvizja e reduktuar e mjeteve

• **Permbeldhje e ndikimeve negative ne mjedis**

Sektori	Presionet mjedisore	Ndikimet	Llojet	Pershkrimi / masat lehtesuese
Cilesia e Ajrit	Emetimi i substancave	Vlerat e pritshme jane te ulta krahasuar me	Rajonal E perhershme	Perqendrimi i ulet rekomandohen



DOKO Sh.P.K

Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k

	ndotese (dioksid karboni CO, NOx, SOx) nga automjetet dhe gjate saldimeve	normen e cilesise se ajrit. Perdorimi i lendeve te pastra, reduktimi i gjeneratorit, lagia e shesheve te pa shtruara.	E prapsueshme	masa lehtesuese duke perdorur karburant te cilesise se pare.
Toka dhe ujrat nentokesore	Prania e ndotesve te mundshem ne toke dhe ujerat nentokesore.	Ambjenti nuk eshte i sistemuar dhe i shtruar me beton dhe mund te kete perdorim e shkarkime te ujerave te ndotura.	Lokale	Te gjitha zonat duhet te jene te shtruara dhe pajisur me sistem kanalizimesh. Mundesia e ndotjes se tokes dhe ujerave nentokesore nuk ekziston.
Shkarkimi i Ujrave te perdorura	Ndotja e ujrave siperfaqesore si rrjedhoje e shkarkimeve te ujerave te aktivitetit te prodhimit te betonit dhe elemneteve prej betoni.	Ndotje e ujerave siperfaqesore pritesa, nga shkarkimet e ujerave te shiut ose larjes se instalimeve dhe mjeteve. Uji eshte menduar te kaloje me pare ne nje grop dekantimi qe sherben edhe si kolektor kryesor i sheshit.	Lokale	Mirembajtja dhe pastrimi i sistemit te kanalizimeve te ujerave te ambjentit.
Zhurma	Emetimi i zhurmave nga procesi i punes.	Funksionimi do te kete ndikime ne ambjentin e punes, por nuk eshte shqetesim per objektet e tjera fqinje, megjithese kufizohet edhe me hapësira te	Lokale E perhershme E prapsueshme	Nuk rekomandohen sepse vleresohen ne nivele te lejueshme. Rekomandohet qe punetoret te perdorin mjete mbrojtese per tu mbrojtur nga

**DOKO Sh.P.K**Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k

		lira.		ndikimi i zhurmes.
Zonat Natyrore dhe te Ndjeshme	Ndikimi mbi habitatet e ndjeshme nga emetimet ne ajer.	Perqendrimet ne ajer e ndotesve do te jene ne perputhje me kufijte e percaktuar nga Direktiva e KE per mbrojtjen e mjedisit.	Rajonal E perhershme E prapsueshme	Menaxhimi i ujerave te perdorur dhe i mbetjeve te ngurta.
Peizazh	Modifikimi i karakteristikave peisazhore	Objekti eshte i rrethuar, kufizuar dhe i sisetmuar	Rajonal E prapsueshme	Rekomandohet mbjellje e pemeve te larta perreth objektit, ne menyre qe te reduktohet impakti ne mjedis per shkak te demtitimit te peizazhit.
Trafiku	Rritja e trafikut rrugor	Furnizimi me lende te pare dhe shitja e produktit do te rrise numrin e kamioneve ne rrjetin rrugor, por ne nivele te uleta.	Lokale E perhershme E prapsueshme	Do te perdoren rruget ekzistuese dhe nuk do te hapen rruge te reja. Infrastruktura eshte ne pergjithesi e mire dhe objekti ndodhet ne afersi te rruges kryesore. Te kufizohet qarkullimi ne pikun e trafikut.
Social Ekonomik	Mundesi te reja punesimi	Gjate funksionimit te instalimeve jane te punesuar disa dhjetera punetore dhe specialist te	Rajonal E perhershme E prapsueshme	Nje vleresim specifik mbi ndikimin social eshte planifikuar te kryhet per te vleresuar me detaje ndikimet



DOKO Sh.P.K

Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k

		mesem e te larte .		pozitive dhe negative te finstalimeve mbi popullsi vendase.
Shendeti Publik	Ndikime ne cilesine e ajrit Zhurma e shkaktuar nga aktiviteti	Perqendrimet e ndotesve te emetuar jane shume te vogla dhe do te jene ne perputhje me gjendjen aktuale te cilesise se ajrit. Nuk parashikohet ndikim ne shendetin e njerezve.	Rajonal E perhershme E paprapsueshme	Nje vleresim specifik mbi ndikimin social eshte planifikuar te kryhet per te vleresuar me detaje ndikimet pozitive dhe negative te linjes mbi popullsi vendase. Ndikimet vleresohen pozitive ne lidhje me zhvillimin e zones.
Ndikime te tjera	Ndikime ne mjedisin natyror dhe shendetesor.	Nepermjet procesit te prodhimit te makinerive e paisjeve.	Rajonal E perhershme	Subjekti te ushtroje aktivitetin brenda normave shqiptare te miratuar, duke u mbeshtetur nga institucionet e mbrojtjes se mjedisit per efektin pozitiv ekonomik-sosocial qe mbart.

MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV

<i>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</i>	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave dhënë në relacion. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.

**DOKO Sh.P.K**Elbasan /Albania
Tel/Fax: 0035558326066
e-mail: info@doko.al
NIPT: J62903324k

Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së të prodhimit. Ndërtimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku janë të instaluar linja e prodhimit të makinerive e paisjeve.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjatë rrugës që bëjnë të mundur hyrjen për në objekt.
Fauna	
Shqetësim i specieve, dëmtim aksidental i tyre	Objekti është i rrethuar, mirëmbajtja dhe rikonstruktimi i tyre në rast dëmtimi. Në regjistrin kombëtarë të specieve të mbrojtura, kjo zonë është e përjashtuar dhe nuk karakterizohet nga specie të mbrojtura dhe nuk përbën shqetësim për habitatin.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve të CO, SO_x, NO_x, PM₁₀, HC (VOC) nga funksionimi i impiantit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit	Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Sistemi i kullimit	
Sistemi i kullimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut, përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një pusëtë të përbashkët, ku më pas do të realizohet shkarkimi në kolektorin kryesorë të kanalizimeve të zonës
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenerëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas llojeve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësi vendore. Asgjësimi i mbetjeve nga kompani të licensuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim në maksimum i mbetjeve metalike.
Ujërat e Ndotura Urbane	Dekantim i ujrave të përdorura duke i deguar në vasken e dekantimit dhe me pas shkarkimi i tyre në kolektorin kryesor të zonës. Lidhja me sistemin e kanalizimeve të zonës. Minimizimi i

	DOKO Sh.P.K	Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k
---	--------------------	--

	konsumit të ujit.
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.
Zjarri	
Mbrojtja nga zjarri	Godina dhe linjat e prodhimit kane një strukturë rezistente ndaj zjarrit, bazamenti mbi te cilin jane instaluar linjat jane konstruksion B/A, Beton Arme me rezistencë të lartë ndaj zjarrit. Linjat jane te mbrojtur nga zjarri dhe në linjat e prodhimit janë të instaluar sensorë të cilët i përcjellin informacion panelit të komandimit për temperaturën e secilës aparaturë, në raste zjarri linja e prodhimit stakohet automatikisht duke siguruar vetë linjen deri në ndërhyrjet nga organet kompetente. Shoqëria ka marrë licensen e mbrojtjes kundra zjarrit, sipas së cilës janë instaluar të gjitha aparaturat dhe paisjet e nevojshme për mbrojtjen e instalimit dhe objektit nga rastet e mundshme të zjarreve.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të tjera
- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambjent të mbyllur kështu që nuk do ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.
- Ndërsa ku do të zhvillojë aktivitetin subjekti është i lidhur me rrjetin e kanalizimeve të zonës së Kombinatit. Subjekti ka ndërtuar një sistem të grumbullimit të rrjedhjeve dhe ujërave sipërfaqësore dhe devijimit të tyre në rrjetin e kanalizimeve.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Nuk kemi gjenerimin e Mbetjeve të rrezikshme.
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kazan të veçantë. Kazanet do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Bashkia Elbasan për

	<p>DOKO Sh.P.K</p>	<p>Elbasan /Albania Tel/Fax: 0035558326066 e-mail: info@doko.al NIPT: J62903324k</p>
---	---------------------------	---

mbetjet urbane. Mbetjet e paketimit do te mblidhen dhe dorezohen ne subjekte te licensuara per perdorimin, riciklimin apo trajtimin e tyre.

- Do te ndiqen gjithe rregullat e sigurimit teknik ne pune si dhe pajisjes se punonjesve me uniformat dhe mjetet e nevojshme te mbrojtjes ne pune.



Pergatiti

Ing. mekanik Edlir PEÇI

Konist teknollog Beqir KILA